



Në bazë të nenit 3 të Vendimit mbi bashkëfinancim të projekteve kulturore (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat komunale”, nr. 47/22), Sekretariati për vetëqeverisje lokale i Komunës së Tuzit shpall

**K O N K U R S P U B L I K
PER BASHKËFINANCIM TË PROJEKTE NË FUSHËN E KULTURËS PËR VITIN
2023**

I

Shpallet konkursi publik për projekte në fushën e veprimtarisë kulturore, gjegjësisht:

1. Veprimtaritë e artit figurativ dhe ekspozitës;
2. Veprimtari botuese;
3. Përkhithim letrar;
4. Veprimtari skenike muzikore.

II

Shuma totale e mjeteve për ndarje është 6,000.00€.

Një projekt individual mund të bashkëfinancohet në masën deri në 50% të shumës totale të kërkuar për realizimin e tij. Një projekt i një rëndësie të jashtëzakonshme për Komunën e Tuzit mund të bashkëfinancohet në një shumë më të madhe se 50% e shumës totale të mjeteve të nevojshme për realizimin e tij.

Pjesëmarrësi i konkursit mund të konkurrojë me një ose më shumë projekte, vetëm njëri prej të cilëve mund të bashkëfinancohet.

Me projekt nënkuftohet tërësia e programit të rrumbullakosur ose një pjesë e tërësisë (zhanrit dhe kohës), i cili kontribuon në arritjen e interesit publik, në përputhje me ligjin.

III

Të drejtë pjesëmarrjeje në Konkurs kanë personat fizikë dhe juridikë me vendbanim në Komunën e Tuzit, përkatësisht nga territori i Komunës së Tuzit, të cilët janë të regjistruar për kryerjen e veprimtarive kulturore.

Personat fizikë mund të konkurrojnë me projekte që i realizojnë në mënyrë të pavarur si vepër autoriale e tyre.

Nuk kanë të drejtë të marrin pjesë organizatat joqeveritare, si dhe institucionet publike dhe subjektet tjera, puna e të cilave financohet nga buxheti i komunës, me mjete të planifikuara për kulturë.

IV

Projektet e paraqitura në konkurs vlerësohen sipas kritereve të mëposhtme:

- 1) cilësia artistike dhe rëndësia për zhvillimin e kulturës së komunës së Tuzit;
- 2) referencat e realizuesit;
- 3) kontribut në zhvillimin e vlerave shumëkombëske dhe multikulturore;
- 4) kontribut në nxitjen e dialogut rajonal dhe nxitjen e zhvillimit të partneritetit;
- 5) afirmimi rajonal i kulturës së komunës së Tuzit;

- 6) kontribut në ruajtjen e traditës dhe trashëgimisë kulturore të Tuzit;
- 7) afirmimi i talenteve premtuese;
- 8) kontribut në afirmimin e krijimtarisë së personave me aftësi të kufizuara;
- 9) realiteti i buxhetit të projektit dhe sigurimi i kushteve për zbatimin e tij.

Organë kompetent mund të përcaktojë kritere të tjera për vlerësimin e projekteve nga një fushë e caktuar e kulturës, në përputhje me ligjin dhe programin kombëtar e lokal të zhvillimit kulturor.

V

Aplikimi për Konkurs dorëzohet në formularin përkatës, i cili gjendet në ueb faqen e komunës së Tuzit dhe direkt në arkivin e komunës.

Së bashku me formularin e plotësuar duhet të dorëzohet edhe dokumentacioni i detyrueshëm për personat fizikë:

- 1) Vërtetim vendbanimi;
- 2) Fotokopje e letërnjoftimit;
- 3) Biografia e aplikantit;
- 4) Për projektet që realizohen me ftesë ose në bazë të bashkëpunimit, dorëzoni letra ftese nga organizatori, letër nga një partner tjetër për qëllimet, etj.;
- 5) Deklaratë se projekti i aplikimit nuk është aktivitet apo pjesë e veprimtarisë së një organizate joqeveritare.

Dokumentacioni shtesë i detyrueshëm sipas fushave

a) Veprimtaritë e artit të bukur dhe ekspozitës:

- 1) rekomandimi i ekspertit;
- 2) fotografitë e veprave të artit nëse janë të ekspozuara;
- 3) fatura paraprake për shtypjen e katalogut nëse është i shtypur.

b) Veprimtaria botuese

- 1) fotokopje e dorëshkrimit të përfunduar dhe të përgatitur për shtypjen e veprës së re letrare që do të batohet, gjegjësisht një botimi;
- 2) të dhënë teknike për veprën ose botimin letrar (format, tirazh, lidhje etj.);
- 3) të paktën një recension;
- 4) vlerësimi për shtypjen e dorëshkrimit të një vepre të re letrare që do të batohet.

c) Përkthimi letrar

- 1) fotokopje e dorëshkrimit të librit ose të librave që përkthehen, gjegjësisht fotokopje e literaturës që do të përkthehet;
- 2) dëshmi e rregullimit të së drejtës së autorit nëse libri ose literatura që përkthehet i nënshtrohet të drejtës së autorit.

d) Veprimtari muzikore dhe muzikore-skenike

- 1) regjistrim partiture ose demo;
- 2) teksti i veprës muzikore;
- 3) rekomandimi i ekspertit;
- 4) Marrëveshja për dhënien me qira të një studioje muzikore;
- 5) letër ftese nga organizatori i festivalit (nëse bëhet fjalë për shfaqje në festivale).

Së bashku me formularin e plotësuar duhet të dorëzohet edhe dokumentacioni i detyrueshëm për personat juridikë:

1. Vendim për regjistrim për kryerjen e veprimtarive kulturore;
2. Akti i Themelimit;
3. Për projektet që realizohen me ftesë ose në bazë të bashkëpunimit, dorëzoni letra fte të organizatorit, letër nga një partner tjetër për qëllimet, etj.;
4. Deklaratë se projekti i aplikimit nuk është aktivitet apo pjesë e veprimtarisë së një organizate joqeveritare.

Dokumentacion shështë i detyrueshëm sipas fushës

a) Për veprimtaritë e artit figurativ dhe ekspozitës

- 1) rekomandimi i ekspertit;
- 2) fotografitë e veprave të artit nëse janë të ekspozuara;
- 3) fatura paraprake për shtypjen e katalogut nëse është i shtypur.

b) Veprimtaria botuese

- 1) fotokopje e dorëshkrimit të përfunduar dhe të përgatitur për shtypjen e veprës së re letrare që do të botohet, gjegjësisht një botimi;
- 2) të dhënrat teknike për veprën ose botimin letrar (format, tirazh, lidhje etj.);
- 3) të paktën një recension;
- 4) vlerësimi për shtypjen e dorëshkrimit të një vepre të re letrare që do të botohet.

c) Përkthimi letrar

- 1) fotokopje e dorëshkrimit të librit ose të librave që përkthehen, gjegjësisht fotokopje e literaturës që do të përkthehet;
- 2) dëshmi e rregullimit të së drejtës së autorit nëse libri ose literatura që përkthehet i nënshtronhet të drejtës së autorit.

d) Veprimtaritë muzikore dhe muzikore-skenike:

- 1) regjistrim partiture ose demo;
- 2) teksti i veprës muzikore;
- 3) rekomandimi i ekspertit;
- 4) Marrëveshja për dhënien me qira të një studioje muzikore;
- 5) letër fte të organizatorit i festivalit (nëse bëhet fjalë për shfaqje në festivale).

Aplikimi me dokumentacion dorëzohet në zarf të mbyllur direkt ose me postë në adresën: Komuna e Tuzit - Sekretariati për Vetëqeverisje Lokale, Tuz pn, me shënimin "**Konkurs për bashkëfinancim të projekteve kulturore (përcaktoni fushën) për vitin 2023**".

- në një kopje të shtypur,
- dhe domosdoshmërisht në formë elektronike (USB, CD ose DVD) në përbajtje identike me kopjen e printuar (aplikacion me të gjitha bashkëngjitjet).

Informacione shtesë mund të merren çdo ditë pune duke telefonuar në numrin 020/875-167 ose në e-mail tuzi@tuzi.org.me

Afati i dorëzimit të aplikimeve me dokumentacion është 30 ditë, nga data e shpalljes së konkursit, duke përfunduar më 12 dhjetor 2022.

VI

Aplikimet e vonuara dhe jo të plota nuk do të merren parasysh. Aplikimet e shkruara me dorë nuk janë të pranueshme. Materiali i konkursit nuk kthehet.

Vlerësimi i projektit kryhet nga komisioni i ekspertëve i formuar nga organi kompetent, nga artistë të afirmuar dhe ekspertë të kulturës.

Vendimi për ndarjen e mjeteve për bashkëfinancimin e projekteve në fushën e kulturës do të publikohet në faqen e Komunës së Tuzit jo më vonë se 40 ditë pas përfundimit të konkursit.

Sekretarja e Sekretariatit për Vetëqeverisje Lokale merr Vendimin për ndarjen e mjeteve për bashkëfinancimin e projekteve në fushën e kulturës dhe lidh kontrata me zbatuesit e përzgjedhur brenda një javë nga përfundimi i vendimit për bashkëfinancim.

**SEKRETARE,
Marina Ujkaj**

